# PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË "GJIROFARMA" SH.A

**Për periudhën:** **01/01/2017 - 31/12/2017**

**Objekti i aktivitetit:** Mbledhja e përpunimi i qumështit, tregtimi i tij dhe nënprodukteve, import eksport tregti mallra të ndryshëm. Prodhim dhe tregtim të lëngjeve dhe të frutave.

**Selia:** Rruga Nacionale Gjirokastër-Kakavije, km 25, Vrisera, zona kadastrale 1234, nr. pasurie 72/25
**NIPT:** K43522610E

**HARTOI:** Robert Lulo Kontabilist i Miratuar
**MIRATOI:** Administratori z. Nikolla Gjoni

Gjirokastër, më 22/03/2018

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

Hartuesi
Robert Lulo - KM
22-03-18

# Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| AKTIVET | 31/12/2017 | 31/12/2016 |
|---|---|---|
| ***Aktivet afatshkurtra*** | | |
| **Mjetet monetare** | **2,442,059** - | **114,002,432** |
| **Investime:** | - | - |
| 1.Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit | | |
| 2.Aksionet e veta | | |
| 3.Të tjera financiare | | |
| **Të drejta të arkëtueshme :** | **34,436,502** | **23,839,209** |
| 1.Nga aktiviteti i shfrytëzimit | 31,581,176 | 23,839,209 |
| 2.Parapagime | 2,653,199 | |
| 3.Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 4.Të tjera (TVSH, Tatim Fitimi etj) | 202,127 | - |
| 5. Kapital i nënshkruar i papaguar | | |
| **Inventarët:** | **166,067,059** | **160,841,307** |
| 1.Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme | 6,578,737 | 10,143,696 |
| 2.Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte | 39,113,518 | 67,301,458 |
| 3.Produkte të gatshme | 115,576,409 | 81,350,041 |
| 4.Mallra | 4,798,395 | 2,046,113 |
| 5.Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri) | | |
| 6.AAGJM të mbajtura për shitje | | |
| 7.Parapagime për inventar | | |
| **Shpenzime të shtyra** | | |
| **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara** | | |
| **Aktive totale afatshkurtra** | **202,945,620** | **70,678,084** |
| ***Aktive afatgjata*** | | |
| **Aktive financiare:** | - | - |
| 1.Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit | | |
| 2.Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit | | |
| 3.Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 4.Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 5.Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata | | |
| 6. Tituj të tjerë të huadhënies | | |
| **Aktivet materiale:** | **210,697,924** | **211,478,917** |
| 1. Toka dhe ndërtesa | 71,560,434 | 72,473,095 |
| 2. Impiante dhe makineri | 93,706,541 | 93,689,152 |
| 3. Të tjera Instalime dhe pajisje | 36,662,448 | 36,548,169 |
| 4. Parapagime për aktive materiale dhe në proces | 8,768,501 | 8,768,501 |
| **Aktive Biologjike** | | |
| **Aktive jo materiale:** | - | - |
| 1.Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme | | |
| 2.Emri i Mirë | | |
| 3.Parapagime për AAJM | | |
| **Aktive tatimore të shtyra** | | |
| **Aktive totale afatgjata** | **210,697,924** | **211,478,917** |
| **AKTIVE TOTALE** | **413,643,544** | **282,157,001** |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| DETYRIME DHE KAPITALI | 31/12/2017 | 31/12/2016 |
|---|---|---|
| ***Detyrime afatshkurtra:*** | ***255,644,498*** | ***117,824,661*** |
| 1.Titujt e huamarrjes | | |
| 2.Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | 183,343,973 | 61,180,300 |
| 3.Arkëtime në avancë për porosi | | |
| 4.Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 15,521,085 | 39,227,098 |
| 5.Dëftesa të pagueshme | | |
| 6.Të pagueshme ndaj ortakëve | 52,305,236 | 14,418,465 |
| 7.Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 8.Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore | 1,037,032 | 827,586 |
| 9.Të pagueshme për detyrimet tatimore | 3,437,172 | 2,171,213 |
| **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | |
| **Të ardhura të shtyra** | | |
| **Provizione** | | |
| **Totali i Detyrimeve afatshkurtra** | **255,644,498** | **117,824,661** |
| ***Detyrime afatgjata:*** | - | - |
| 1.Titujt e huamarrjes | | |
| 2.Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | | |
| 3.Arkëtimet në avancë për porosi | | |
| 4.Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | | |
| 5.Dëftesa të pagueshme | | |
| 6. Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit | | |
| 7.Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 8.Të tjera të pagueshme | | |
| **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | |
| **Të ardhura të shtyra** | | |
| **Provizione:** | - | - |
| 1.Provizione për pensionet | | |
| 2. Provizione të tjera | | |
| **Detyrime tatimore të shtyra** | | |
| **Totali i Detyrimeve afatgjata** | - | - |
| **DETYRIMET TOTALE** | **255,644,498** | **117,824,661** |
| ***Kapitali dhe Rezervat*** | | |
| **Kapitali i Nënshkruar** | **144,914,000** | **144,914,000** |
| **Primi i lidhur me kapitalin** | | |
| **Rezerva rivlerësimi** | | |
| **Rezerva të tjera** | **671,067** | **671,067** |
| 1.Rezerva ligjore | 671,067 | 671,067 |
| 2.Rezerva statutore | | |
| 3.Rezerva të tjera | | |
| **Fitimi i pashpërndarë** | | **7,664,738** |
| **Fitim / Humbja e Vitit** | **12,413,979** | **11,082,535** |
| **Totali i Kapitalit** | 157,999,046 | 164,332,340 |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | **413,643,544** | **282,157,002** |

# Pasqyra e Performancës
## (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
### Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

| | 2017 | 2016 |
|---|---|---|
| **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** | **286,728,784** | **262,767,895** |
| **Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces** | **7,134,671** | **6,657,725** |
| **Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar** | | |
| **Të ardhura të tjera të shfrytëzimit** | **28,200** | |
| **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** | **226,479,094** | **190,512,696** |
| 1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 226,479,094 | 190,512,696 |
| 2. Të tjera shpenzime | | |
| **Shpenzime të personelit** | **16,930,456** | **14,960,971** |
| 1. Paga dhe shpërblime | 14,507,707 | 12,819,256 |
| 2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore | 2,422,749 | 2,141,715 |
| **Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale** | | |
| **Shpenzime konsumi dhe amortizimi** | **2,231,569** | **2,460,066** |
| **Shpenzime të tjera shfrytëzimi** | **23,283,704** | **35,794,469** |
| **Të ardhura të tjera** | **385,288** | **94,647** |
| 1. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata | | |
| 3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | 385,288 | 94,647 |
| **Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra** | | |
| **Shpenzime financiare** | **10,724,730** | **12,651,395** |
| 1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | 10,416,401 | 12,651,395 |
| 2. Shpenzime të tjera financiare | 308,328 | |
| **Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet** | | |
| **Fitimi/Humbja para tatimit** | **14,627,392** | **13,140,671** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | **2,213,413** | **2,058,136** |
| 1. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | 2,213,413 | 2,058,136 |
| 2. Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë | | |
| 3. Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve | | |
| **Fitimi/Humbja e vitit** | **12,413,979** | **11,082,535** |
| **Fitimi/Humbja për:** | | |
| Pronarët e njësisë ekonomike mëmë | | |
| Interesat jo-kontrolluese | | |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

ROBERT LULO
KONTABEL I MIRATUAR
L53408603T

# Pasqyra e Performancës
## (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
### Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas funksionit

| | 2017 | 2016 |
|---|---|---|
| **Të ardhura të shfrytëzimit** | **286,756,984** | **262,767,895** |
| **Kosto të shitjeve** (përfshirë shpenzime të amortizimit dhe zhvlerësimit) | **226,479,094** | **190,512,696** |
| **Fitimi/humbja bruto** | **60,277,890** | **72,255,199** |
| **Shpenzime të shpërndarjes** (përfshirë shpenzime të amortizimit dhe zhvlerësimit) | **2,231,569** | **2,460,066** |
| **Shpenzime administrative** (përfshirë shpenzime të amortizimit dhe zhvlerësimit) | **40,214,160** | **50,755,440** |
| **Të ardhura të tjera** | **7,519,959** | **6,752,372** |
| 1. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | 7,134,671 | 6,657,725 |
| 2.Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 3.Të ardhura nga investime dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata | | |
| 4.Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | 385,288 | 94,647 |
| **Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra** | | |
| **Shpenzime financiare** | **10,724,730** | **12,651,395** |
| 1.Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | 10,416,401 | 12,651,395 |
| 2. Shpenzime të tjera financiare | 308,328 | - |
| **Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet** | | |
| **Fitimi/Humbja para tatimit** | **14,627,392** | **13,140,671** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | **2,213,413** | **2,058,136** |
| 1. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | 2,213,413 | 2,058,136 |
| 2. Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë | | |
| 3. Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve | | |
| **Fitimi/Humbja e vitit** | **12,413,979** | **11,082,535** |
| **Fitimi/Humbja për:** | | |
| Pronarët e njësisë ekonomike mëmë | | |
| Interesat jo-kontrolluese | | |

ROBERT LULO
KONTABEL I MIRATUAR
L53408603T

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

| | 2017 | 2016 |
|---|---|---|
| **Fitimi/Humbja e vitit** | **12,413,979** | **11,082,535** |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:** | | |
| **Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja** | | |
| **Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale** | | |
| **Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje** | | |
| **Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet** | | |
| **Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin** | | |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin** | **12,413,979** | **11,082,535** |
| **Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:** | | |
| Pronarët e njësisë ekonomike mëmë | | |
| Interesat jo-kontrolluese | - | - |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

KONTABEL I MIRATUAR
L53408603T

# Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
## (Metoda Indirekte)

| | | 2017 | | 2016 |
|---|---|---|---|---|
| ***Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit*** | | | | |
| Fitim / Humbja e vitit | | 12,413,979 | | 11,082,535 |
| **Rregullimet për shpenzimet jomonetare:** | | **2,231,569** | | **2,460,066** |
| Shpenzimet financiare jomonetare | | | | |
| Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar | | | | |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | | 2,231,569 | | 2,460,066 |
| Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale | | | | |
| **Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:** | | **-** | | **-** |
| Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | | | |
| **Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:** | **-** | **166,881** | **-** | **0** |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | - | 10,597,293 | - | 0 |
| Rënie/(rritje) në inventarë | - | 5,225,752 | | - |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | | 15,446,718 | | - |
| Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit | | 209,446 | | - |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit** | | 14,478,666 | | 13,542,601 |
| ***Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit*** | | | | |
| Para neto të përdorura për blerjen e filialeve | | | | |
| Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve | | | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | - | 1,450,575 | - | 1,576,451 |
| Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | | | |
| Pagesa për blerjen e investimeve të tjera | | | | |
| Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera | | | | |
| Dividentë të arkëtuar | | | | |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit** | - | 1,450,575 | - | 1,576,451 |
| ***Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit*** | | | | |
| Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar | | | | |
| Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral | | | | |
| Hua të arkëtuara | | 130,906,861 | | |
| Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë | | | | |
| Riblerje e aksioneve të veta | | | | |
| Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral | | | | |
| Pagesa e huave | | | | - |
| Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare | | | | |
| Interes i paguar | - | 8,743,188 | - | 10,147,347 |
| Dividendë të paguar | - | 18,747,273 | | |
| **Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit** | | 103,416,400 | - | 10,147,347 |
| **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare** | | **116,444,491** | | **1,818,804** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar** | **-** | **114,002,432** | **-** | **114,002,432** |
| Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare | | | | |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor** | | **2,442,059** | **-** | **114,002,432** |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43322610F
Gjirokastër - ALBANIA

# Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto
## (Pasqyra Individuale)

| | Kapitali i nënshkruar | Primi i lidhur me kapitalin | Rezerva Rivlerësimi | Rezerva Ligjore | Rezerva Statutore | Rezerva të tjera | Fitimet e Pashpërndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali | Interesa Jo-Kontrollues | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015*** | 144,914,000 | - | - | 671,067 | - | - | 7,664,738 | 9,263,732 | 162,513,537 | | 162,513,537 |
| Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | | | | | | | |
| ***Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016*** | 144,914,000 | - | - | 671,067 | - | - | 16,928,470 | | 162,513,537 | | 162,513,537 |
| ***Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:*** | | | | | | | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | | | | | 11,082,535 | 11,082,535 | | 11,082,535 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | | | | | | | | - | | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | - | - | - | - | - | 11,082,535 | 11,082,535 | | 11,082,535 |
| ***Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:*** | | | | | | | | | | | |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | | | | | - | | - |
| Dividendë të paguar | | | | | | | - 9,263,732 | | - 9,263,732 | | - 9,263,732 |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | - | - | - | - | - | - | - 9,263,732 | - | - 9,263,732 | | - 9,263,732 |
| ***Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016*** | 144,914,000 | - | - | 671,067 | - | - | 7,664,738 | 11,082,535 | 164,332,340 | | 164,332,340 |
| ***Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017*** | 144,914,000 | - | - | 671,067 | - | - | 18,747,273 | | 164,332,340 | | 164,332,340 |
| ***Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:*** | | | | | | | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | | | | | 12,413,979 | 12,413,979 | | 12,413,979 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | | | | | | | | - | | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | - | - | - | - | - | 12,413,979 | 12,413,979 | | 12,413,979 |
| ***Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:*** | | | | | | | | | | | |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | | | | | - | | - |
| Dividendë të paguar | | | | | | | - 18,747,273 | | - 18,747,273 | | - 18,747,273 |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | - | - | - | - | - | - | - 18,747,273 | - | - 18,747,273 | | - 18,747,273 |
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017** | 144,914,000 | - | - | 671,067 | - | - | 0 | 12,413,979 | 157,999,046 | | 157,999,046 |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K4...

**GJIROFARMA SH.A.**
**Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare**
**më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

**Gjirofarma Sh.A.** është një Shoqëri Aksionere, themeluar më 11 Qershor 2005, regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, datë 10 Korrik 2005, me NIPT K43522610E. Shoqëria ndodhet në Rrugën nacionale Gjirokaster-Kakavije, km25, Vrisera, Gjirokastër.

Sistemi i administrimit është me dy nivele : Administratori dhe Këshilli Mbikqyrës.
Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është z. Nikolla Gjoni.
Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Dhimiter Boboli
2. Suzana Vasi
3. Roland Aleksi

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 144.914.000,00 lekë, i ndarë në 72,457 aksione me vlerë nominale 2,000 lekë/aksion. Aksionerët e Shoqërisë janë :

1. Antonios Ouzas me përqindje pjesëmarrjeje 50%
2. Piro Karranxha me përqindje pjesëmarrjeje 50%

Aktiviteti i Shoqërisë është: "Mbledhja e perpunimi i qumështit, tregtimi i tij dhe nënprodukteve, import eksport tregti mallra të ndryshem. Prodhimin dhe tregtimi i lëngjeve dhe i frutave"

Më 31 Dhjetor 2017 Shoqëria kishte 42 (dyzet e dy) punonjës.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES

### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke respektuar parimin e kostos historike.

### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga Manaxhimi të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat që ndikohen në të ardhmen.
Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

### 3.1 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të kësaj date.
Fitim ose humbje nga kurset e këmbimit në njësi monetare është diferenca që rezulton nga konvertimi i një numri të dhënë njësish në monedhë të huaj në LEK me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivet dhe detyrimet jomonetare të shprehura në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që shprehen me vlerë të drejtë rivlerësohen në LEK me kurs këmbimi të datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Diferencat e kurseve të këmbimit që lindin nga rivlerësimi i aktiveve monetare njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kursi zyrtar i këmbimit i përdorur për përgatitjen e pasqyrave financiare (LEK kundrejt monedhës përkatëse) për monedhën Euro, e cila është edhe monedha e vetme e huaj në të cilën shoqëria kryen transaksione, në 31 Dhjetor 2017 ishte 132.95.

### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përfshijnë llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe llogari të pagueshme dhe të tjera.
Instrumentat financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.
Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë vlerësohen si më poshtë.
Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë e një provizioni kontraktual të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse e drejta kontraktuale e Shoqërisë për rrjedhat monetare nga aktivet financiare skadon ose nëse Shoqëria transferon aktivet financiare në një palë tjetër duke humbur kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet që vijnë nga instrumenti. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohen në datën e tregtimit, për shembull në datën kur Shoqëria blen ose shet aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimi i Shoqërisë i specifikuar në kontratë skadon ose shfuqizohet apo anullohet.

*Mjete monetare dhe ekuivalente*
Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*
Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

*Llogari të pagueshme*
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogaritë e tjera të pagueshme janë paraqitur me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interest efektiv

GJIROFARMA SH.A
Nipt K46522610E
Gjirokastër ALBANIA

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.2 Transaksione në monedhë të huaj (vazhdim)

*Huatë*
Shoqëria ka hua vetëm ne monedhën vendase LEK.

*Të tjera*
Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

*Vlera e drejtë*
Vlera e drejtë e mjeteve monetare, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme dhe huave dhe të ngjashmeve është e njëjtë me vlerën kontabël neto.

*Metoda e interesit efektiv*
Metoda e interesit efektiv është një metodë llogaritje e kostos së amortizuar e detyrimeve financiare dhe e shpërndarjes së shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma që skonton rrjedhat e ardhshme të pagesave gjatë kohëzgjatjes së parashikuar të detyrimit financiar ose gjatë një periudhe më të shkurtër.

### 3.3 Inventari

Inventari regjistrohet me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet në bazë mesatareje të përdorur. Vlera neto e realizueshme përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuara për përfundimin dhe kostot e nevojshme për të realizuar shitjen.

### 3.4 Aktivet afatgjata materiale

*(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjen nga zhvlerësimet.

Kosto përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen drejpërdrejt me sjelljen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre, koston e çmontimit dhe heqjes së njësive dhe risistemimi i vendit ku ato ndodheshin.
Kur pjesë të një makinerie apo pajisje kanë kohëzgjatje të ndryshme përdorimi, kontabilizohen si pjesë më vete të makinerisë ose pajisjes (pjesë të mëdha).
Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(ii) Kosto vijuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive apo pajisjeve njihet në vlerën kontabël të njësisë nëse ekziston mundësia që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në këtë pjesë do të rrjedhin drejt Shoqërisë dhe kosto e saj mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të makinerive dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.

ROBERT LULO
KONTABILIST I MIRATUAR
GJIROFARMA SH.A
Nipt K43...
Gjirokastër - ALBANIA

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.4 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

*(iii) Amortizimi*
Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën mbi vlerën e mbetur për çdo aktiv afatgjatë material.
Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

Metoda dhe normat e amortizimit të përdorura janë si më poshtë:

| **Kategoria** | **Normat e amortizimit** |
|---|---|
| Ndërtesa | 2% |
| Makineri dhe Instalime | 1% |
| Te tjera | 1% |

### 3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet jo-materiale të blera nga Shoqëria, maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi. Amortizimi është llogaritur mbi koston e aktivit, ose vlerën që e zëvendëson atë, duke i zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, llogaritur bazuar në jetën e dobishme te AJM-së. Shoqëria nuk ka Aktive afatgjate Jomateriale.

### 3.6 Rënia në vlerë

*a) Aktivet financiare*
Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe ka patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të flukseve monetare të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme. Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit.
Aktive të rëndësishme financiare, janë testuar për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen bashkarisht në grupe që ndajnë të njëjtat karakteristika të rrezikut të kreditit.
Një humbje nga zhvlerësimi mund të anullohet nëse anullimi mund të lidhet në mënyrë të arsyeshme me nje ngjarje të ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të vlerësuara me koston e amortizuar anullimi njihet në pasqyrën në të ardhura.

*b) Aktivet jo-financiare*

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbja nga nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo njësia e tij e krijimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje.

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet që ofrohen gjatë aktivitetit normal të biznesit, neto nga zbritjet apo tatime të lidhura me shitjet. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet e mallrave dhe shërbimeve në fjalë janë transferuar në mënyrë të konsiderueshme tek konsumatori.

***Shitja e mallrave***

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ka transferuar pjesën më të madhe të rreziqeve dhe përfitimeve nga pronësia e mallrave tek bleresi;
- Shoqëria nuk përfshihet në manaxhimin në nivelet që zakonisht lidhen me pronësinë dhe nuk ka kontroll efektiv ndaj produkteve të shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në Shoqëri; dhe
- Kostot e ndodhura ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

***Të ardhura të tjera***

Të ardhurat nga interesi njihen kur Shoqërisë i lind e drejta e arkëtimit të tyre.

### 3.8 Përfitimet e punonjësve

*Kontributet shoqërore dhe shëndetësore*
Shoqërisë i kërkohet nga legjislacioni aktual shqiptar të japë kontribute fikse në emër të punonjësve në një fond social që manaxhohet nga shteti. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato janë të lidhura.

### 3.9 Provigjionet

Një provigjion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime aktuale ligjore ose kontraktuale, të cilat mund të llogariten me besueshmëri, dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të fluksit të parasë, skontuar me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve.

### 3.10 Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen si humbje ose fitim në bazë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Stimujt e qirasë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

### 3.11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga amortizimi të njohura në aktivet financiare. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen neto.

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.12 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt ne kapital apo në të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pasigurtë të pozicionit të taksave dhe nëse mund të ngarkohen taksa shtesë ose interesa. Shoqëria beson se shpenzimet e përllogaritura të saja për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj për shumë faktorë, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe përvojave të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në parashikime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme duke ndikuar në ndryshimin e vendimit të Shoqërisë në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojë në shpenzimet tatimore në periudhën që është bërë një përcaktim i tillë.

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## 3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 3.13 Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar më poshtë.

*Tatimi mbi fitimin*
Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

*Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale*
Siç është përshkruar në shënimin 3.4, Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## 4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTË

Mjetet monetare dhe ekuivalentët përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2017 | Më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| **Arka** | **1,231,515** | **807,817.25** |
| Në Lek | 1,225,715 | 807,817.25 |
| Në Monedhë të huaj | 5,800 | |
| **Llogari rrjedhëse** | **1,210,544** | **1,068,351.81** |
| Në monedhë të huaj | 30,729 | 127,692.28 |
| Në Lek | 1,179,815 | 940,659.53 |
| **Overdraft** | 0 | -115.878.601,15 |
| **Totali** | **2,442,059** | **-114,002,432.09** |

## 5. INVENTARË

Shoqëria ka gjëndje inventari si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2017 | Më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| a) Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme | 6,578,737 | 10,143,696 |
| b) Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte | 39,113,518 | 67,301,458 |
| c) Produkte të gatshme | 115,576,409 | 81,350,041 |
| d) Mallra | 4,798,395 | 2,046,113 |
| **Totali** | **166,067,059** | **160,841,307** |

## 6. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2017 | Më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Llogari të arkëtueshme nga palët e treta | 31,581,176 | 23,839,209 |
| Llogari të arkëtueshme/Parapagime | 2,653,199 | |
| Humbje nga llogaritë e arkëtueshme | - | - |
| Të tjera (me doganen) | 202,127 | - |
| **Totali** | **34,436,502** | **23,839,209** |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## 7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale janë përbërë si më poshtë:

| | Toka | Ndertime | Makineri dhe pajisje | Mjete Transporti | Aktive te tjera afatgjate materiale | Aktive afatgjate materiale ne proces | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mbetje më 31 Dhjetor 2016 | 26,840,000 | 51,051,108 | 103,850,942 | 34,731,839 | 7,542,307 | 8,768,501 | 232,784,597 |
| Shtesa | | | 900,999 | 522,576 | 27,000 | | |
| Pakësime | | | | | | | |
| **Mbetje në 31 Dhjetor 2017** | **26,840,000** | **51,051,108** | **104,751,941** | **35,254,415** | **7,569,307** | **8,768,501** | **234,235,172** |
| **Amortizim i akumualuar** | | | | | | | |
| Mbetje më 31 Dhjetor 2016 | - | 5,417,912 | 10,161,790 | 5,316,063 | 409,914 | - | 21,305,680 |
| Amortizimi vjetor | - | 912,662 | 883,610 | 281,175 | 154,122 | | **2,231,569** |
| **Mbetje në 31 Dhjetor 2017** | - | **6,330,574** | **11,045,400** | **5,597,238** | **564,037** | - | **23,537,249** |
| **Vlera kontabël neto e AAM** | | | | | | | |
| **Mbetje në 31 Dhjetor 2016** | 26,840,000 | 45,633,196 | 93,689,152 | 29,415,675 | 7,132,393 | 8,768,501 | 211,478,917 |
| **Mbetje në 31 Dhjetor 2017** | **26,840,000** | **44,720,434** | **93,706,541** | **29,657,177** | **7,005,271** | **8,768,501** | **210,697,924** |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

ROBERT LULO
KONTABEL I MIRATUAR
L53408801T

## 8. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Shoqëria nuk ka Aktive afatgjata jomateriale .

## 9. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE DHE TË PAGUESHME TË TJERA

Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

| | **Më 31 dhjetor 2017** | **Më 31 dhjetor 2016** |
|---|---|---|
| Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 15,521,085 | 39,227,098 |
| Të pagueshme ndaj punonjësve dhe Sig. Shoqërore | 1,037,032 | 827,586 |
| Detyrime të tjera ndaj shtetit | 3,437,172 | 2,171,213 |
| **Totali** | **19,995,289** | **42,225,896** |

## 10. TË PAGUESHME NDAJ ORTAKËVE

Shoqëria ka shuma të pagueshme ndaj ortakëve si më poshtë:

| | **Më 31 dhjetor 2017** | **Më 31 dhjetor 2016** |
|---|---|---|
| Të pagueshme ndaj ortakëve | 52,305,236 | 14,418,465 |
| **Totali** | **52,305,236** | **14,418,465** |

## 11. HUATË

Shoqëria ka hua bankare në monedhën vendase LEK si më poshtë:

| | **Më 31 dhjetor 2017** | **Më 31 dhjetor 2016** |
|---|---|---|
| Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | 183,343,973 | 61,180,300 |
| **Totali** | **183,343,973** | **61,180,300** |

## 12. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i Shoqërisë dhe struktura e tij për datën 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2017 përkatësisht është si më poshtë:

ROBERT LULO
KONTABEL I MIRATUAR
L53406603T

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

| | 2017 | | 2016 | |
|---|---|---|---|---|
| | **Në %** | **Në Lek** | **Në %** | **Në Lek** |
| Antonios Ouzas | 50% | 72,457,000.00 | 50% | 72,457,000.00 |

| | | 2017 | | 2016 |
|---|---|---|---|---|
| | **Në %** | **Në Lek** | **Në %** | **Në Lek** |
| Piro Karanxha | 50% | 72,457,000.00 | 50% | 72,457,000.00 |
| **Totali** | **100%** | **144,914,000.00** | **100%** | **144,914,000.00** |

**Pasqyra e kapitalit aksionar është si më poshtë:**

ROZETA LULO
KONTABEL I MIRATUAR
L53408803T

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

*(Të gjitha shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)*

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva Ligjore | Fitimet e Pashpërndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015** | 144,914,000 | 671,067 | 7,664,738 | 9,263,732 | 162,513,537 |
| Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016** | **144,914,000** | **671,067** | **16,928,470** | | **162,513,537** |
| **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | 11,082,535 | 11,082,535 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | | | | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | - | **11,082,535** | **11,082,535** |
| Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital: | | | | | |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | - |
| Dividendë të paguar | | | -9,263,732 | | -9,263,732 |
| Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike | - | - | -9,263,732 | - | -9,263,732 |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016** | **144,914,000** | **671,067** | **7,664,738** | **11,082,535** | **164,332,340** |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017** | **144,914,000** | **671,067** | **18,747,273** | | **164,332,340** |
| Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin: | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | 12,413,979 | 12,413,979 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | | | | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | - | **12,413,979** | **12,413,979** |
| Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital: | | | | | |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | - |
| Dividendë të paguar | | | -18,747,273 | | -18,747,273 |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | - | - | **-18,747,273** | - | **-18,747,273** |
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017** | **144,914,000** | **671,067** | **0** | **12,413,979** | **157,999,046** |

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA

## 13. PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE SIPAS NATYRËS

| | Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2017 | Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** | **286,728,784** | **262,767,895** |
| **Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces** | **7,134,671** | **6,657,725** |
| **Të ardhura të tjera të shfrytëzimit** | **28,200** | **0** |
| **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** | **226,479,094** | **190,512,696** |
| 1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 226,479,094 | 190,512,696 |
| **Shpenzime të personelit** | **16,930,456** | **14,960,971** |
| 1. Paga dhe shpërblime | 14,507,707 | 12,819,256 |
| 2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore | 2,422,749 | 2,141,715 |
| **Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale** | | |
| **Shpenzime konsumi dhe amortizimi** | **2,231,569** | **2,460,066** |
| **Shpenzime të tjera shfrytëzimi** | **23,283,704** | **35,794,469** |
| **Të ardhura të tjera** | **385,288** | **94,647** |
| 1. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | 385,288 | 94,647 |
| **Shpenzime financiare** | **12,651,395** | **12,651,395** |
| 1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | 10,416,401 | 12,651,395 |
| 2. Shpenzime të tjera financiare | 308,328 | |
| **Fitimi/Humbja para tatimit** | **14,627,392** | **13,140,671** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | **2,213,413** | **2,058,136** |
| 1. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | 2,213,413 | 2,058,136 |
| **Fitimi/Humbja e vitit** | **12,413,979** | **11,082,535** |

ROBERT LULO KONTROLL I MIRATUAR L53008603T

GJIROFARMA SH.A Nipt K43522610E Gjirokastër - ALBANIA

**Shënime shpjeguese për Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës për :**

**Shpenzimi I Tatimit mbi Fitimin**

| | Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| **Fitimi kontabël para tatimit** | **14,627,392** | **13,140,671** |
| *Rregullime:* | | |
| Rritje e të ardhurave sipas raportit të autoriteteve tatimore | 0 | 0 |
| *Shpenzimet e pazbritshme* | 128,693 | 580,233 |
| **Fitimi i tatueshëm** | **14,756,085** | **13,720,904** |
| **Tatimi mbi fitimin15%** | **2,213,413** | **2,058,136** |

## 14. PALËT E LIDHURA

Për qëllim të këtyre pasqyrave financiare palët konsiderohen të lidhura në qoftë se njëra prej palëve ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale sic përcaktohet në SKK 2 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura". Kur merret në konsideratë cdo palë e lidhur e mundshme, vëmendja drejtohet në natyrën e marrëdhënies, dhe jo thjesht formës ligjore. Shoqëria nuk ka transaksione me palë të lidhura.

## 15. GARANCI DHE ANGAZHIME

Nuk ka garanci apo angazhime.

## 16. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas dates së raportimit që kërkojnë rregullim apo prezantim në këto pasqyra financiare.

**HARTOI:**

**ROBERT LULO**
**KONTABILIST I MIRATUAR**

**MIRATOI:**

**NIKOLLA GJONI**
**ADMINISTRATOR**

GJIROFARMA SH.A
Nipt K43522610E
Gjirokastër - ALBANIA